



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE

REPUBLIC OF ALBANIA  
MINISTRY OF FINANCE

# RAPORTI VJETOR ANNUAL REPORT



# 2008

Rruga "Dora D'Istria" Nr.2, Tiranë  
Tel./Fax: +355 4 2244 602  
Internet: <http://www.fint.gov.al>  
E-mail: [public.relations@fint.gov.al](mailto:public.relations@fint.gov.al)

© **DPPPP / GDPML**

Përgatiti për botim:  
Shtëpia Botuese **BOTART**

## Mesazh i Drejtorit të Përgjithshëm

Kam kënaqësinë e veçantë të prezantoj Raportin Vjetor 2008, i cili përmbledh aktivitetin dhe punën e bërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), duke bashkëpunuar ngushtë me strukturat informative e të zbatimit të ligjit në Shqipëri, si dhe me homologët tanë ndërkombëtarë.

Po mbushen 8 vjet nga krijimi i Njësisë së Inteligjencës Financiare Shqiptare, si një njësi administrative në varësi të Ministrisë së Financave, e njohur fillimisht si Drejtoria e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave (DBLKPP), dhe mbi tre vjet që kjo njësi është ngritur dhe funksionon në nivelin e Drejtorisë së Përgjithshme, me pavarësi administrative dhe buxhetore.

Viti 2008 ishte një vit i rëndësishëm për DPPPP- në dhe për gjithë strukturat informative e të zbatimit të ligjit, të përfshira në parandalimin dhe goditjen e fenomeneve të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit. Ndryshime të rëndësishme janë bërë në legjislacionin shqiptar për t'a përafuar atë me standartet ndërkombëtare të FATF- së, si dhe me direktivën e tretë të BE-së. Miratimi në maj të vitit 2008 i Ligjit Nr. 9917 "Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit", ka ngritur në një stad të ri arritjet e Qeverisë shqiptare për të parandaluar dhe luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Këto ndryshime ligjore janë paraprirë nga ndryshime strukturore dhe rritja e kapaciteteve në pajisje e teknologji për DPPPP- në. Gjatë këtij viti, për herë të parë, në NjIF Shqiptare është krijuar Sektori i Teknologjisë së Informacionit, bazuar në moton që nuk ka Inteligjencë pa Teknologji Informacioni. Po kështu, duke punuar ngushtësisht me Delegacionin e BE- së dhe partnerët ndërkombëtarë, DPPPP- ja ka qenë aktive në draftimin e implementimin e tre projekteve të financuara nga BE- ja, në

## Message from the General Director



I have the particular pleasure of presenting the 2008 Annual Report, which incorporates the activity and the work accomplished by the General Directorate for the Prevention Money Laundering (GDPML), by cooperating closely with informative and law enforcement institutions in Albania as well as our international partners .

Eight years have already elapsed since the establishment of the Albanian Financial Intelligence Unit, as an administrative unit within the Ministry of Finance known originally as the Directorate for the Coordination of the Fight

Against Money Laundering (DCFAML). Three years ago the directorate was promoted to a General Directorate vested with administrative and budgetary independence.

2008 was an important year for GDPML and all informative and law enforcement institutions involved in the prevention and fighting the money laundering and terrorism financing phenomenon. The Albanian legislation has undergone significant changes aiming at bringing it into line with the international standards of FATF and the Third EU Directive. The approval in May 2008 of the Law, No.9917 "On the prevention of money laundering and terrorism financing", has elevated to a new level the accomplishments of the Albanian Government in preventing money laundering and fighting terrorism financing.

The legislative changes were preceded by structural changes and the enhancement of technological equipment of GDPML. During this year, for the first time ever, an Information Technology Section was established within the FIU, based on the slogan that "no intelligence can exist without information technology". Furthermore, the GDPML has cooperated closely with the EU Delegation and international partners and has been actively involved in the drafting and implementation of

një shumë totale rreth 2 milion EURO, disa nga këto të filluara që nga viti 2007.

Rritja e kërkesës së llogarisë, menaxhimi efektiv i burimeve, futja e teknologjisë së informacionit në menaxhimin e rasteve të dyshimta, kanë bërë që me të njejtin nivel burimesh njerëzore, logjistike e financiare si në vitin 2007, të rritet ndjeshëm mbledhja e informacionit, të thellohet analiza financiare dhe të shtohen mbi 10 herë rastet e referuara në prokurori apo në organet e zbatimit të ligjit.

Viti 2009 do të jetë një vit sfide për DPPP- në. Realizimi dhe vënia në punë e programit analitik për mbledhjen, analizimin dhe dedektimin e rasteve të dyshimta, raportimi i progresit të bërë gjatë dy viteve të fundit përpara Komitetit të ekspertëve MONEYVAL të KE- së në shtator 2009, përfundimi i draftimit të strategjisë kombëtare afatmesme e afatgjatë në fushën e parandalimit dhe goditjes së pastrimit të parave e financimit të terrorizmit në kuadër të Projektit të Binjakëzimit me kolegët e BKA- së, kërkojnë angazhimin dhe përfshirjen totale të gjithë stafit të DPPP- së, si dhe rritjen e koordinimit e të bashkëpunimit me policinë, prokurorinë, homologët rajonalë dhe më gjerë.

Do të dëshiroja ta mbyllja fjalën time, duke cituar Kryeministrin SHTZ Berisha në analizën vjetore të vitit 2008 të Policisë së Shtetit: "Asgjë më e dëmshme, asgjë më toksike nuk është për ekonominë se sa paratë e krimit, prandaj sa më shumë t'i presim rrugën futjes së tyre në ekonomi, aq më e madhe do të jetë rritja ekonomike dhe zhvillimi i Shqipërisë".

Duke përfunduar, falënderoj gjithë punonjësit e DPPP- së, që me angazhimin e gatishmërinë e tyre kanë bërë të mundur të ndjehet puna dhe të vlerësohen rezultatet e Njësisë së Inteligjencs Financiare Shqiptare.

three projects financed by the EU amounting to 2 million EUR. Some of those projects had commenced in 2007.

An ever growing demand for accountability, effective management of resources, introduction of information technology capabilities in the managing of suspicious activities, have led to a significant increase in the amount of information collected, deepening of financial analysis and a tenfold increase in the number of referrals to prosecutor's office and other law enforcement agencies while the human, logistical and financial resources available were the same as in 2007.

The year 2009 will be challenging for the GDPML. The completion and the functioning of the analytical software that allows the collection, analysing and detection of suspicious activities, the reporting in September 2009 to the MONEYVAL Committee in the Council of Europe, of the progress made for the last two years, the conclusion of a medium and long term national draft strategy for the prevention and striking of money laundering and terrorism financing in the framework of the Twinning Project with BKA colleagues, demand a total commitment from the GDPML staff, as well as an increase in cooperation and coordination with the police, prosecutors office, regional partners and beyond.

I would like to conclude my speech by mentioning the Prime Minister's statement in the 2008 annual assessment of the Albanian State Police: "Nothing is more destructive, nothing is more toxic for the economy than the money derived from crime, therefore the less we allow it to infiltrate the economy the greater will be the economic growth and development in Albania".

In the end, I would like to thank all the GDPML employees, who through their eagerness and dedication have succeeded in their work and achieved significant results for the Albanian FIU.

**Arben DOÇI**



Drejtor i Përgjithshëm / General Director

## PËRMBAJTJA

MESAZH I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM	3
Shkurtime	7
Datat kryesore	8
HYRJE	9
REFORMA LEGJISLATIVE	11
Komiteti i Bashkëndimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave	14
PUNA ME PROJEKTET	16
MENAXHIMI I BURIMEVE DHE I PERFORMANCËS	19
Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave	19
Rekrutimi, trajnimi dhe vlerësimi i punës së punonjësve	20
Realizimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit	21
Kontrolle e auditime të kryera nga institucione të tjera kundrejt DPPP- së	22
ZBATIMI I MASAVE PARANDALUESE	24
Ndërgjegjësimi i subjekteve raportuese	24
Inspektimet	26
Masat administrative të marra	28
MBLEDHJA, ANALIZIMI DHE SHPËRNDARJA E TË DHËNAVE TË TRANSAKSIONEVE FINANCIARE	29
Raportimi i transaksioneve të aktiviteve të dyshimta nga subjektet raportuese	29
Raportimi i aktiviteve të dyshimta nga disa Institucione Partnere	31
Deklarimet e valutës në pikat e kalimit kufitar	32
Raportimi i transaksioneve të vlerave nga bankat si subjekte kryesore raportuese	33
Raportimi i transaksioneve të vlerave nga noterët dhe analizimi i tyre	35
Raportimi i transaksioneve të vlerave nga subjektet e tjera të ligjit	38
Analizimi financiar dhe teknologjia e informacionit	39
Referimi i rasteve të dyshimta në prokurori	42
Raste të dërguara në Policinë e Shtetit për investigim të mëtejshëm	44
Kordinimi dhe bashkëpunimi	46
BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL	46
BASHKËPUNIMI ME PARTNERË DHE INSTITUCIONE NDËRKOMBËTARE	49
Marrveshjet e bashkëpunimit	49
BASHKËPUNIMI ME NJESITË HOMOLOGE TË RAJONIT	51
BASHKËPUNIMI ME GRUPIN EGMONT	52
SHKËMBIMI I INFORMACIONIT ME ANË TË RRJETIT ESW	53
KOMITETI MONEYVAL	54
OBJEKTIVAT	55



## CONTENTS

MESSAGE FROM THE GENERAL DIRECTOR	3
Acronyms	7
Important milestones	8
INTRODUCTION	9
LEGISLATIVE REFORM	11
Committee for the Coordination of the Fight Against Money Laundering	14
PROJECTS	16
MANAGEMENT OF RESOURCES AND PERFORMANCE	19
Organization of the General Directorate for the Prevention of Money Laundering	19
Recruitment, training and the assessment of the employee performance	20
Budget implementation and performance	21
Auditing and controls of GDPML activities carried out by other institutions.	22
IMPLEMENTATION OF PREVENTIVE MEASURES	24
Awareness enhancement of the reporting entities	24
Inspections	26
Administrative Sanctions	28
COLLECTION, ANALYSIS AND DISSEMINATION OF FINANCIAL TRANSACTIONS DATA	29
The reporting of suspicious transactions	29
Suspicious activity reports received by the partner institutions.	31
Cross border cash declaration	32
Reporting of value transactions from the entities	33
Value transaction reporting from the notaries and their analysis	35
Reporting of value transactions from other legal entities	38
Financial Analysis and Information technology	39
The referral of suspicious cases to the prosecutor's Office	42
Cases sent to the State Police for further inquiry	44
Coordination and cooperation	46
INSTITUTIONAL COOPERATION	46
COOPERATION WITH INTERNATIONAL PARTNERS AND INSTITUTIONS	49
Memorandums of Understanding	49
COOPERATION WITH THE REGIONAL HOMOLOGUE UNITS	51
COOPERATION WITH EGMONT GROUP	52
THE EXCHANGE OF INFORMATION THROUGH THE ESW NETWORK	53
MONEYVAL COMMITTEE	54
OBJECTIVES	55

## Shkurtime

AMF – Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare  
BE – Bashkimi Evropian  
BSH – Banka e Shqipërisë  
DBLKPP - Drejtoria e Bashkëndimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave  
DPD - Drejtoria e Përgjithshme e Doganave  
DPP – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë  
DPPPP - Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave  
DPT - Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve  
EGMONT – Rrjeti i Njësive të Inteligjencës Financiare në Botë  
EKA – Ekspert Kontabël i Autorizuar  
FATF - Grupi i Veprimit Financiar  
IEKA - Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar  
ILDKP - Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive  
KBLKP - Komiteti i Bashkëndimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave  
KE – Këshilli i Evropës  
KKBLKPP - Komiteti Kombëtar për Bashkëndimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave  
LKFT - Lufta Kundër Financimit të Terrorizmit  
MONEYVAL - Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave  
NjPH - Njësia e Përbashkët e Hetimit të Krimit Ekonomiko-Financiar dhe Korrupsionit në Drejtorinë e Tiranës  
OJF - Organizatë Jo Fitimprurëse  
OJQ - Organizatë Jo Qeveritare  
OPDAT – Zyra e Projektit për Zhvillim dhe Trajnime e Departamentit të Drejtësisë e Shteteve të Bashkuara  
OSCE – Organizata për Bashkpunim dhe Sigurinë në Evropë  
PAMECA – Misioni i Asistencës Policore i Bashkimit Evropian në Shqipëri  
PEP – Personat e Ekspozuar Politikisht  
PP - Prokuroria e Përgjithshme  
PPP- Parandalimi i Pastrimit të Parave  
SHISH – Shërbimi Informativ Shtetëror  
TI – Teknologjia e Informacionit  
ZKV - Zyrë Këmbimi Valutor  
ZQRPP - Zyra Qëndrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme  
ZVRPP - Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

## Acronyms

AML - Anti Money Laundering  
ASP - Albanian State Police  
BKA - German Federal Criminal Office  
BoA – Bank of Albania  
CCFAML - Committee for the Coordination of the Fight Against Money Laundering  
CoE - Council of Europe  
CORRE - Central Office for the Registration of Real Estate  
DBLKPP - Directorate for the Coordination of the Fight Against Money Laundering  
EGMONT - International Network of Financial Intelligence Units  
ESW - Egmont Secure Web  
EU - European Union  
FATF - Financial Action Task Force  
FIC - Financial Intelligence Center  
FIU - Financial Intelligence Unit  
FSA - Financial Supervisory Authority  
FT - Financing of Terrorism  
GDC - General Directorate of Customs  
GDPML - General Directorate for the Proevention of Money Laundering  
GPO - General Prosecutor's Office  
GDT - General Directorate of Taxation  
HIDAA - High Inspectorate for the Declaration and Control of Assets  
ICPA - Institute of Certified Public Accountant  
IT - Information Technology  
JIU - Joint Investigation Unit  
LORRE - Local Office for the Registration of Real Estate  
MONEYVAL - Committee of Experts for the Evaluation of Measures against Money Laundering and Financing of Terrorism in the Council of Europe  
NAIS - National Agency for the Information Society  
NGO - Non Governmental Organizations  
NIA - National Information Agency  
NPO - Non Profit Organizations  
OPDAT - Office of Overseas Prosecutorial Development and Training  
OSCE - Organisation for Security and Cooperation in Europe  
PAMECA - Police Assistance Mission of The European Community to Albania  
PEP - Politically Exposed Persons  
SAR - Suspicious Activity Report  
VTR - Value Transaction Report

## Datat kryesore

- Në muajin maj të vitit 2000, Parlamenti Shqiptar, pas disa kërkesave të KE-së dhe të Komitetit MONEYVAL, miraton Ligjin nr. 8610 datë 17.05.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”.
- Në gusht të vitit 2001, krijohet Drejtoria e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave, në Ministrinë e Financave.
- Në qershor të vitit 2003, Parlamenti Shqiptar, në zbatim të kërkesave të raportit të vlerësimit të dytë të Shqipërisë, nga komiteti MONEYVAL, bën disa ndryshime të rëndësishme të ligjit për “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave”, nëpërmjet miratimit të ligjit nr. 9084 datë 19.06.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8610, datë 17.05.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave””.
- Në korrik të po këtij viti, Njësia e Inteligjencës Financiare të Shqipërisë bëhet anëtare me të drejta të plota në grupin EGMONT, gjatë sesionit plenar të mbajtur në Australi.
- Në gusht të vitit 2005, Drejtoria e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave, ngrihet në nivelin e Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, në Ministrinë e Financave.
- Në mars të vitit 2006, u publikua raporti i parë vjetor i DPPP-së.
- Në gusht të vitit 2006, KKBLKPP- ja miraton Programin Kombëtar të Kontrollit të Lëvizjes së Parasë në dorë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Në nëntor të vitit 2006, miratohen Ligjet nr. 9641, datë 20.11.2006, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për Parandalimin e Terrorizmit” dhe nr. 9646, datë 27.11.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e produkteve të krimi dhe të financimit të terrorizmit”.
- Në janar të vitit 2008, me Urdhër të Kryeministrit të Shqipërisë, miratohet struktura e re e DPPP-së, në të cilën krijohet për herë të parë Sektori i Teknologjisë së Informacionit.
- Në muajin maj të vitit 2008, Parlamenti Shqiptar miraton Ligjin nr. 9917 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i cili përmbush rekomandimet e Komitetit MONEYVAL, pranë Këshillit të Evropës të bëra në raport, vlerësimin e III reciprok, MONEYVAL-SHQIPERI, si dhe ato ndërkombëtare të FATF- së.
- Në shtator të vitit 2008, hyn në fuqi Ligji nr. 9917 datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.
- Në dhjetor të vitit 2008, zhvillohet takimi i Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave.

## Important milestones

- In May of the year 2000, the Albanian Parliament, after repeated requests from the MONEYVAL Committee of CE approved the Law no. 8610 datë 17.05.2000 “On the prevention of money laundering”.
- In August of the year 2001, the Directorate for the Coordination of the Fight Against Money Laundering within the Ministry of Finance is created.
- In June of the year 2003 the Albanian Parliament, based on the demands of the second round of evaluation from the MONEYVAL Committee, made some important amendments to the law “On the prevention of money laundering” by approving the law No. 9084 of June 19, 2003 “On some additions and amendments in the law No. 8610, datë 17.05.2000 “On the prevention of money laundering””.
- In July of the same year, the Albanian Financial Intelligence Unit became a member with full rights of EGMONT group, during the plenary session held in Australia.
- In August of 2005 the Directorate for the Coordination of the Fight Against Money Laundering (DCFAML) was promoted to a General Directorate within the Ministry of Finance.
- In March of 2006 the first annual report of GDPML is published.
- In August of 2006, CCFAML approves the National Program for the Control of Cash in the Republic of Albania.
- In November of 2006, approval of Law nr. 9641, of 20.11.2006, “On the ratification of European Council Convention “For the prevention of terrorism” and Law nr.9646, of 27.11.2006 “On the ratification of European Council Convention “On the search, seizure and confiscation of proceeds of crime and terrorism financing”
- In January of 2008, GDPML undergoes a reorganization process based on the order of the Prime Minister. An IT section is established for the first time.
- In May 2008, the Albanian Parliament approves the Law No. 9917 “On the prevention of money laundering and terrorism financing”. This law fulfils the recommendations of the MONEYVAL Committee in the CE, that were made during the third round of mutual evaluation MONEYVAL-ALBANIA, as well as the FATF recommendations.
- In September 2008 the Law No. 9917 datë 19.05.2008, “On the prevention of money laundering and terrorism financing” became effective.
- In December 2008, a meeting of the Committee for the Coordination of the Fight Against Money Laundering was convened.



# HYRJE

Viti 2008 ka qenë një vit ndryshimesh e reformash të rëndësishme për Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Parave, si dhe për të gjithë sistemin shqiptar të luftës kundër pastrimit të parave e financimit të terrorizmit. Këto reforma kanë synuar në rritjen e kapaciteteve profesionale të vetë Njesisë së Inteligjencës Financiare shqiptare, por dhe të Njësive të tjera si ajo e Hetimit të Krimin Ekonomik dhe Korrupsionit, përmirësimit të bashkëpunimit ndërinstytucional, si dhe rritjen e shkëmbimit të informacionit ndërmjet DPPP-së dhe agjencive të zbatimit të ligjit.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit në vitin 2006, konsolidimi i shtetit ligjor, forcimi i institucioneve të gjitha niveleve dhe në veçanti, zbatimi i ligjit dhe administrimi i sistemit të drejtësisë ka marrë një rëndësi të veçantë. Disa nga prioritetet që Qeveria Shqiptare ka pasur për përmbushjen e detyrimeve në kuadrin e MSA-së, janë zbatimi me efektivitet të legjislacionit mbi luftën kundër pastrimit të parave përsa i përket dënimeve, konfiskimeve dhe ngrirjes së aseteve, përmirësimi i monitorimit të sektorit financiar, reduktimi i përdorimit të parasë fizike në ekonominë e vendit, përputhja e legjislacionit mbi parandalimin e pastrimit të parasë me standartet e BE-së, rritja e nivelit të bashkëpunimit me autoritetet e vendeve të tjera, duke përdorur në veçanti rrjetin rajonal të Inteligjencës Financiare, si dhe përmirësimi i kapacitetit të DPPP-së, Prokurorisë dhe strukturave të Luftës Kundër Krimin Ekonomik e Financiar të Policisë, duke rritur dhe koordimin e punës së tyre.

Me gjithë përpjekjet e vazhdueshme për të arritur synimet e sipërpërmendura, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe strukturat brenda saj, janë përballur me shumë sfida e pengesa gjatë vitit 2008, disa nga të cilat janë:

- Mungesa e programeve analitike dhe e bazave të nevojshme të të dhënave;
- Puna me burime njerëzore të pamjaftueshme;
- Miratimi i ligjit të ri për parandalimin e pastrimit të parave dhe

# INTRODUCTION

Year 2008 has been a year of change and important reforms for the General Directorate for the Prevention of Money Laundering and for the Albanian institutions involved in the fight against money laundering and financing of terrorism. These reforms have aimed at enhancing the professional capacities of the Albanian Financial Intelligence Unit, as well as those of other agencies such as the Unit for the Investigation of Economic Crimes and Corruption, improvement of inter institutional cooperation and the increase of information exchange among GDPML and other law enforcement agencies.

Upon the signature of the Stabilisation and Association Agreement (SAA) in 2006, the consolidation of rule of law, the strengthening of institutions in all levels and in particular that of the law enforcement and the administration of justice system are of a particular importance. Some of the priorities set by the Albanian Government are geared towards the fulfilment of the obligations assumed in the SAA, such as the more effective implementation of anti money laundering legislation with respect to prosecutions, asset freezing and forfeiture, improvement of the financial sector oversight, reduction of cash usage in the national economy, harmonising the anti money laundering legislation with the EU standards, expanding the level of cooperation with partner institutions abroad by especially using the regional financial intelligence network and the improvement of the capabilities, for GDPML, Prosecutor's Office and the Economic Crimes Unit within the police by furthering the coordination of their activities.

Despite the continuous efforts to accomplish the goals mentioned above, GDPML and its structures have confronted several challenges and obstacles during 2008, such as:

- The lack of analytical software and the necessary databases;
- Insufficient human resources;
- The approval of the new anti money laundering law and coping with a staggering increase in the number of reports received from

financimit të terrorizmit dhe përballja me rritjen galopante të raportimeve nga subjektet raportuese të ligjit, si rezultat i hyrjes në fuqi të ligjit, por dhe i inspektimeve të vazhdueshme;

- Pjesëmarrja në grupet e hartimit të akteve nënligjore dhe formularëve përkatës të raportimit dhe finalizimi i tyre;
- Monitorimi dhe asistimi profesional i një pjese të madhe të subjekteve raportuese të ligjit;
- Vendosija dhe vënia në përdorim e teknologjisë së re të TI- së për DPPP- në, si dhe puna për përpilimin e termave të referencës për dizejimin e një programi analitik, në bashkëpunim me Delegacionin e Komisionit Evropian;
- Tejkalimi i pritshmërisë për rastet e referuara për pastrim parash dhe financim terrorizmi në organet e zbatimit të ligjit, duke sfiduar kohën e gjatë që merr letërkëmbimi i informacionit.

Krahas përbushjes së detyrave të përditshme dhe sfidave të sipërpërmendura, personeli i DPPP-së ka marrë pjesë intensivisht në aktivitetet e projektit të binjakëzimit me kolegët gjermanë të Policisë Kriminale Federale (BKA), si dhe në aktivitete të tjera në kuadër të grupit EGMONT, në Komitetin e Ekspertëve MONEYVAL të Këshillit të Evropës, në nivel rajonal, etj.

the reporting entities. The increase is attributed the new law as well as the continuous inspections;

- Participation in the working groups that were established to prepare the bylaws, the relevant forms and their completion.
- Monitoring and professional assistance for a large part of the reporting entities;
- Installation of the new IT equipments for the GDPML and their operation, the preparation of the Terms of Reference for the acquirement and the design of an analytical software, in cooperation with the European Union Delegation ;
- Exceeding the expectations for money laundering case referrals in law enforcement agencies, by overcoming difficulties caused by the long time that the information exchange takes;

Along with the fulfillment of daily tasks and challenges mentioned above, the GDPML staff has actively participated in the activities of the Twinning Project with German colleagues of the German Federal Criminal Office (BKA) and other activities such as those organized by the EGMONT Group, the Committee of Experts MONEYVAL of Council of Europe, as well as activities at the regional level.

## REFORMA LEGJISLATIVE

Në verën e vitit 2005 u zhvillua raundi i III i vlerësimit të Shqipërisë në fushën e luftës dhe parandalimin e pastrimit të parave e financimit të terrorizmit nga Komiteti MONEYVAL (Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave të Luftës Kundër Pastrimit të Parave).

Në këtë raund u evidentua rëndësia dhe nevoja konkrete për ndryshime rrënjësore në legjislacionin shqiptar. Nisur nga rekomandimet e Komitetit MONEYVAL, pranë Këshillit të Evropës, si dhe të institucioneve të tjera ndërkombëtare si FMN-ja, në nëntor 2006 ka nisur puna për hartimin e ligjit të ri mbi Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Drafti i parë i hartuar nga zyra Juridike e FMN-së, në vjeshtë të vitit 2006 u diskutua për mbi një vit nga një grup pune me ekspertë nga:

- Ministria e Financave dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.
- Banka e Shqipërisë si autoriteti mbikqyrës dhe rregullues i veprimtarisë bankare dhe veprimatrive të tjera bankare.
- Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm dhe Policia e Shtetit, si organet kryesore të zbatimit të ligjit në Republikën e Shqipërisë.

Në këtë Grup Pune morën pjesë, në cilësinë e vëzhguesit edhe përfaqësues të OSCE-së, të Delegacionit të BE-së në Shqipëri, të Bankës Botërore, të OPDAT-it, si dhe Këshilltari i Departamentit Amerikan të Thesarit pranë DPPPP-së.

Pas përgatitjes së variantit përfundimtar të ligjit, Grupi vazhdoi punën për mbledhjen e mendimeve nga grupet e interesit, subjekte të këtij ligji, Autoritetet Mbikqyrëse të tyre, si dhe institucione të tjera, (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Zyra Qendrore e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive etj). Ky projekt iu dërgua për mendim organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare me prezencë në Shqipëri si: PAMECA, Delegacioni i BE-së, OPDAT-i, Banka Botërore, OSBE-ja dhe Departamenti i Thesarit Amerikan.

## LEGISLATIVE REFORM

The Third Round of evaluation by the MONEYVAL Committee, of Albania's progress in the field of prevention of money laundering and terrorism financing was held in the summer of 2005.

During this round the need and the importance of radical changes of the Albanian legislation, became apparent. Based on the recommendations of the MONEYVAL in the Council of Europe as well as those by other institutions such as the IMF, preparation for the formulation of the new law on Prevention of Money Laundering started in November of 2006. The first draft was put together by the Legal Office of the IMF and was discussed for over a year by a working group of experts from:

- The Ministry of Finance and the General Directorate for the Prevention of Money Laundering.
- Bank of Albania as the supervisory and regulatory authority for the banking and non-banking activities.
- General Prosecutor's Office and the State Police as the main law enforcement institutions in the Republic of Albania.

Participants from OSCE, EU Delegation in Albania, World Bank, OPDAT (Overseas Prosecutorial Development, Assistance and Training), US Treasury Department adviser at the GDPML, had an observer status in the working Group.

After the final version was prepared, the Group continued deliberations and exchange of opinions with interest groups and entities regulated by this law, their Oversight Authorities and other institutions (General Directorate of Customs, Tax Authority, Central Office for the Registration of Real Estate, High Inspectorate for the Declaration and Control of Assets, etc).

This draft was also sent for feedback to international organizations and institutions present in Albania such as: PAMECA, EU Delegation, OPDAT, World Bank, OSCE and US Treasury Department.

On March 26, 2008 the draft law was presented by the Council of Ministers for deliberation to the Albanian Parliament. The law was de-

Më 26 mars 2008, projektligji nga Këshilli i Ministrave iu paraqit për shqyrtim Parlamentit Shqiptar, ku u diskutua në tre grupe parlamentare, si ai i Sigurisë Kombëtare dhe i Mbrojtjes, Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, si dhe në Komisionin e Ligjeve. Ndryshime të rëndësishme u propozuan dhe u inkluduan në projekt, nga diskutimet në këto komisione.

Ligji nr. 9917 “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit” u aprovua nga Parlamenti Shqiptar me 19 maj 2008 dhe pas dekretimit, (dekreti nr. 5746 datë 09 qershor 2008) nga Presidenti i Republikës, hyri në fuqi më 10 shtator 2008. Ligji i ri është shprehje e nevojës për përmirësime të thella në këto fusha dhe pasqyron vullnetin e mirë të Qeverisë Shqiptare në luftën kundër pastrimit parave, duke u përpjekur t’i bëjë ballë kësaj sfide të rëndësishme të kohës sonë.

Ky ligj synon parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit në përputhje me standartet ndërkombëtare, Rekomandimet 40+9 të FATF- së (Task Forcës së Veprimit Financiar), me rekomandimet e Komitetit MONEYVAL, si dhe me Direktivën 2005/60, datë 26 tetor 2005 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian “Mbi parandalimin e shfrytëzimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit”

Risitë më kryesore të Ligjit të ri krahasuar me legjislacionin ekzistues, janë:

- Futja për herë të parë e detyrimit për raportimin e transaksioneve CASH, mbi pragun e 1,5 milion lekëve, është një përafrim me legjislacionin evropian, e pikërisht me direktivën e III të BE- së mbi parandalimin e sistemeve financiare për pastrim parash dhe do të luajë një rol të rëndësishëm edhe në reduktimin e përdorimit të transaksioneve me para në dorë.
- Inkludimi bashkë me masat parandaluese për pastrimin e parave edhe i atyre të financimit të terrorizmit.
- Ulja e pragut të raportimit të transaksioneve nga 20 milionë lekë në 6 milionë lekë.
- Rritja e numrit të subjekteve raportuese
- Zgjerimi i kuadrit të masave parandaluese që duhet të ndërmerren nga institucionet financiare e jo-financiare në lidhje me politikat

bated in the National Security and Defense Committee, the Economy and Finance Committee and the Legal Committee. Several important changes were proposed and were included in the draft law following the discussions in the committees.

The Law No.9917 “On the prevention of Money Laundering and Terrorism Financing” was approved by the Albanian Parliament on May 19, 2008 based on the decree (decree No.5746 June 9, 2008) of the President of the Republic, and became effective on September 10, 2008. The new law, is an expression of the necessity for sweeping improvements in these areas and demonstrates the willingness of the Albanian government in the fight against money laundering, by tackling this important challenge of our times.

This law aims at the prevention of money laundering and the financing of terrorism in line with the international standards, 40+9 FATF Recommendations (Financial Action Task Force), recommendations of the MONEYVAL Committee as well as the Directive 2005/60, of October 26, 2005 of EU Parliament and Council of Europe “On the prevention of the use of the financial system for the purpose of money laundering and terrorist financing”

Some of the major changes introduced in the new legislation compared to the existing one, are;

- The introduction for the first time of the obligation for the reporting of all cash transactions above 1.5 Million Lek. This brings the Albanian legislation a step closer to the European one, and namely the Third EU Directive on the prevention of money laundering in the financial systems. This stipulation is expected to further reduce the amount cash transactions.
- Inclusion of pre-emptive measures with regard to terrorism financing in addition to those that address prevention of money laundering.
- Threshold reduction for all transactions reports, from 20 million lek to 6 million lek.
- An increase in the number of reporting entities.

e parandalimit të PP/FT- së, masa këto që parashikohen të ndërmerren jo vetëm nga subjektet e ligjit, por dhe nga autoritetet mbikëqyrëse e licensuese të tyre

- Monitorimi me kujdes të zgjeruar i marrëdhënieve të biznesit të subjekteve të këtij ligji me klientët PEP (Persona të Ekspozuar Politikisht) dhe OJF, etj.

Një përpjekje e madhe është bërë nga DPPPP- ja, për hartimin e akteve nënligjore. Që në korrik të vitit 2008 janë ngritur dy grupe pune në DPPPP, që kanë punuar për hartimin e drafteve, të cilat janë diskutuar më pas me subjektet e ligjit, si dhe me autoritetet licensuese e mbikëqyrëse. Përfshirja në draftimin e këtyre projekteve të subjekteve, të cilave u drejtohen, Bankave, Noterëve, Avokatëve, si dhe Autoriteteve të tyre Mbikëqyrëse, Ministrisë së Drejtësisë, Dhomës së Noterisë dhe Shoqatës së Bankave ka krijuar një frymë të re bashkëpunimi, që do të rrisë edhe rezultatet në fushën e parandalimit të pastrimit të parave.

Në të njëjtën frymë është punuar edhe në përpilimin e akteve nënligjore për mënyrat e raportimit nga doganat dhe zyrat e tatim-taksave pranë autoritetit Përgjegjës – DPPPP- së, duke i diskutuar këto drafte me kolegët e DPD- së dhe të DPT-së.

Në dhjetor të vitit 2008 nga DPPPP-ja, janë përfunduar pjesa më e madhe e projekt-akteve nënligjore dhe i janë dërguar Ministrisë së Financave për miratim. Kështu janë përpiluar projekt-udhëzimet:

- Projekt-Udhëzimi i Ministrisë të Financave “Për metodat dhe procedurat e raportimit të subjekteve raportuese të Ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.
- Projekt-Udhëzimi i Ministrisë të Financave “Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të profesioneve të lira jofinanciare”.
- Projekt-Udhëzimi i Ministrisë të Financave “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftës për financimin e terrorizmit në sistemin doganor”.
- Projekt-Udhëzimi i Ministrisë të Financave nr. 16, datë 16.02.2009, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftës për financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”.

- An expansion of preventive measures to be undertaken by financial and non-financial institutions with respect to AML/CFT prevention policies . Such measures should also be taken by the oversight authorities
- Enhanced Due Diligence and ongoing monitoring of business relationships the entities of this law establish and conduct with PEP clients and Not for Profit Organizations, etc.

Significant efforts have been directed by GDPML towards the formulation of by-laws. Two working groups were established in July 2008 to that end. The reporting entities, oversight and licensing authorities were also consulted. The inclusion in the drafting process of entities such as banks, notaries, attorneys and their supervisory authorities, Justice Ministry, Chamber of Notaries and the Albanian Banker’s Association has contributed towards the creation of a spirit of cooperation that will lead to more results in the prevention of money laundering.

The drafting of by laws for the reporting methods of the customs and tax authorities was carried out in the same spirit by the GDPML, accompanied with discussions with experts from the above mentioned institutions

GDPML had completed by December 2008, most of the by-laws listed below and sent them to the Ministry of Finance for approval.

- Draft – Guidance of the Minister of Finance “On the methods and procedures of reporting from the reporting entities of the Law No. 9917, of May 19, 2008 “On the prevention of money laundering and the terrorism financing”.
- Draft – Guidance of the Minister of Finance “On the reporting methods and procedures of designated non-financial businesses and professions”.
- Draft – Guidance of the Minister of Finance “On the prevention of money laundering and terrorism financing in the taxation system”.
- Draft – Guidance of the Minister of Finance “On the prevention of money laundering and terrorism financing in the taxation system”.

Reforma ligjore që përmbledh miratimin e Ligjit nr .9917 dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, përfaqëson fazën e parë të përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian në këtë fushë, dhe arrihet përputhshmëria e pjeshme me *acquis communautaire*, si një hap i rëndësishëm drejt përafrimit të legjislacionit kombëtar me atë evropian, në fushën e parandalimit të pastrimit të parave e financimit të terrorizmit.

## Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave

Komiteti Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave (KBLKPP) është autoriteti më i lartë në vend që përcakton drejtimet e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave e financimit të terrorizmit, si dhe shqyrton e analizon raportet e NjIF.

Ky komitet drejtohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje: Ministrin e Financave, Ministrin e Punëve të Jashtme, Ministrin e Mbrojtjes, Ministrin e Brendshëm, Ministrin e Drejtësisë, Prokurorin e Përgjithshëm, Guvernatorin e BSH- së, Drejtorin e SHISH-it dhe Inspektorin e Përgjithshëm të ILDKP- së.

Në mbledhjen e rradhës të këtij Komiteti, të datës 16 dhjetor 2008, u raportua nga çdo anëtar për masat e marra në zbatim të Programit Kombëtar “Për kontrollin e lëvizjes së monedhës Cash në Republikën e Shqipërisë”, i miratuar nga Kryeministri, në gusht të vitit 2006. Nga raportimi rezultoi se DPPPP-ja kishte marrë të gjitha masat e parashikuara në këtë program duke arritur rezultate, fakt i cili u mbështet nga anëtarët e Komitetit, drejtues të institucioneve partnere bashkëpunuese, gjatë diskutimeve të tyre. siç janë :

Në kuadër të reduktimit të përdorimit të parasë fizike janë marrë disa masa nga institucionet shqiptare, ndër të cilat mund të përmendim:

- Zbatimi më efikas i kuadrit rregullator dhe mbikqyrës për zyrat e këmbimit valutor, gjë që ka çuar në formalizimin e këtij segmenti të ekonomisë shqiptare.
- Forcimi i kontrolleve në pikat e kalimit për kalimin e padeklaruar

The legal reform that comprises Law No.9917 and its by-laws represents the first stage in the harmonisation of the national anti money legislation with that of the European Union and ensures a partial compliance with the *acquis communautaire*, as an important step towards the approximation of the national legislation with the European legislation in the area of prevention of money laundering and terrorism financing.

## Committee for the Coordination of the Fight Against Money Laundering

The Committee for the Coordination of the Fight Against Money Laundering is the highest authority in the country that engages in general governmental policy making in the area of prevention of money laundering and the fight against terrorism financing.

The Committee is chaired by the Prime Minister and it counts among its members: the Minister of Finance, the Minister of Foreign Affairs, the Minister of Defense, the Interior Minister, the Minister of Justice, the General Prosecutor, the Governor of the Bank of Albania, the Director of Intelligence Service and the General Inspector of HIDAA.

In the meeting of this committee in December 16, 2008, each member reported on the measures taken towards implementing the National Program “On the control of cash in the Republic of Albania”, approved by the Prime Minister in August of 2006.

Based on the reporting, GDPML had already taken all the measures prescribed in this program and the achieved results were recognized by the members of the Committee and heads of partner institutions in their discussions.

Within the scope of the reduction of use of cash several measures have been undertaken by the Albanian institutions, some of which are listed below;

- A more effective implementation of a regulatory and oversight regime for bureaux de change, that has contributed towards formalizing this segment of the Albanian economy.
- Strengthening of the controls in the border crossings with regard

të valutës në kufi.

- Rritja e shkëmbimit të informacionit, të kallëzimeve për ndjekje penale, si dhe procedimeve penale për persona që kryejnë shkëmbime valutore pa licencë, ose që tentojnë të kryejnë kalime të padeklaruara të valutës në kufi.
- Ndryshimi i procedurave për sistemin e tatimeve që ka bërë të detyrueshëm kalimin nëpërmjet sistemit bankar të të gjitha transaksioneve me vlerë mbi 300 mijë lekë, edhe për sektorin privat.

Kryeministri theksoi domosdoshmërinë e një angazhimi të madh e gjithnjë në rritje në këtë luftë të vështirë, duke e cilësuar pastrimin e parave një fenomen tejet të rrezikshëm, një autostradë të krimit. Kryeministri nënvizoi se krimi nuk luftohet me sukses pa një luftë të vendosur ndaj pastrimit të parave dhe porositi se ashtu si për luftën kundër krimit të organizuar, edhe ndaj fenomenit të pastrimit të parave duhet adoptuar toleranca zero.

Gjithashtu u diskutua mbi rëndësinë dhe forcimin e bashkërendimit ndërinstitucional në luftën kundër pastrimit të parave e financimit të terrorizmit dhe konkretisht edhe lejimin e përdorimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, të bazës së të dhënave të organeve shtetërore dhe regjistrave publikë.

Kryeministri porositi rritjen e efikasitetit nga Policia e Shtetit për zbatimin e paketës ligjore, Antimafia si një mjet shumë i rëndësishëm kundër krimit të organizuar, por dhe në goditjen e fenomenit të pastrimit të parave. Në mënyrë më specifike, pjesëmarrësit diskutuan mbi fuqizimin e strukturave që luftojnë pastrimin e parave, trajnimin e stafit bazuar mbi përvojën më të mirë ndërkombëtare, si dhe fuqizimin e rrjetit të IT-së dhe përdorimin e tij sa më gjerësisht në luftën kundër pastrimit të parave.

Në takim u ra gjithashtu dakord me ndryshimet e propozuara dhe u miratua rregullorja e funksionimit të këtij Komiteti në zbatim të nenit 23 të Ligjit nr. 9917, datë 19.05.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

to undeclared cash or other valuables.

Siç mund të shikohet nga grafiku, vihet re një rritje graduale vit pas viti, që arrin kulmin në vitin 2007, në një total 748 RAD. Në këtë numër përfshihen informacione të paraportuara më parë nga Bankat, që u konsideruan si anormale ose të dyshimta vetëm pas inspektimeve të kryera. Pas analizimi të tyre u konkludua, që përmbanin kryesisht elementë të evazionit fiskal.

Bazuar në informacionin që përmbajnë RAD- et, tendencat kryesore mund të kategoriazohen si më poshtë:

- blerje pasurish të paluajtshme të pajustificuara me burimin e të ardhurave;
- huadhënie midis individëve në shuma të mëdha.
- transaksione me kompani “guackë”;
- transferim të kapitalit jashtë vendit të pajustificuar;
- evazion fiskal;
- tranfesta kryer në drejtim të kompanive të basteve on line jashtë vendit;
- këmbime valutore në shuma të mëdha nga individë të palicencuar për ushtrimin e këtij aktiviteti;
- transfertat të disa individëve në drejtim të një individi apo kompanie jashtë vendit;
- kryerje transaksionesh biznesi nga llogaritë individuale;
- transfertat të shumta nga një individ drejt shumë përfituesve;

Tipologjia e RAD-ve, e cila haset më shpesh është ajo e transfertave të shumë individëve në drejtim të një përfituesi kryesisht me Turqinë, Kinën, Gjermaninë etj. Lidhur me këtë fenomen, i cili orienton drejt evazionit fiskal, disa raste janë referuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe i është propozuar Departamentit të Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë, të parashikojë dhe të hartojë rregullore ku të ndalohen transfertat e individëve drejt kompanive të huaja pa dokumentacion ligjor tatimor.

Në krahasim me vitin 2007 ka një ulje të raportimeve të transaksioneve

As it can be glanced from the chart the growth in the number of reports has grown continuously peaking in 2007, when a total of 748 SAR were received. This number also includes information that was not previously reported by the banks and were considered as unusual by the examiners. On further analysis they were found to contain mostly tax evasion elements.

Based on the information provided in the SARs the main trends can be categorised:

- Acquisition of real estate using funds whose origin is not justified;
- High individual loans .
- Transactions with “shell” companies;
- Electronic transfers to gambling companies abroad;
- Currency exchange in large volume by unlicensed operators;
- Transfers from several individuals to one individual or company abroad;
- Conducting business transactions from individual accounts;
- Multiple transactions from individual to several beneficiaries;

The typology encountered the most related to SARs is the transfer of multiple individuals to one beneficiary mainly in Turkey, China, Germany etc. This is a phenomenon that points to tax evasion and several cases have been referred to the Customs Authority and a proposal has been made to the Supervisory Department in the Bank of Albania to introduce rules that would prohibit the fund transfers of individuals to foreign companies without being accompanied with the necessary legal and fiscal documentation.

Compared to 2007 there has been a decrease in the number of suspicious transactions reports, nevertheless their quality has improved . During 2008 a total of 152 SAR has been received out of which 92 about 60% contain sufficient elements of suspicion.

të aktiviteteve të dyshimta, por rritje në cilësinë e këtyre raportimeve. Gjatë vitit 2008 janë raportuar 152 RAD-e, nga të cilat kanë rezultuar me elementë të mjaftueshëm dyshimi 92 raste, ose 60% e tyre. Pas analizimit financiar janë referuar për investigime të mëtejshme pranë organeve të zbatimit të ligjit 29 prej tyre. Pjesa tjetër, 60 RAD-e, janë në proces analizimi dhe kërkim të dhënash nga DPPPP-ja.

Për noterët, si subjekti i dytë raportues më i rëndësishëm nisur nga volumi i raportimit ashtu dhe nga cilësia e informacionit, gjatë vitit 2008 janë raportuar 4 RAD-e, që kryesisht kanë të bëjnë me huadhënie dhe premtime për shitje pasurie të paluajtshme, të cilat janë në proces analizimi financiar.

## Raportimi i aktiviteteve të dyshimta nga disa Institucione Partnere

Gjatë vitit 2008 institucionet partnere kanë raportuar si më poshtë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, dy transaksione të aktivitetit të dyshimtë, që janë konkluduar me referim në organet e zbatimit të ligjit. Gjatë këtij viti, vlen të theksohen njoftimet e ardhura nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve të Shkodrës në lidhje me 7 subjekte me objekt veprimtarie në fushën e tregtimit të karburanteve që nuk kanë prani fizike në adresën e deklaruar. Nga Drejtoria janë marrë masa për bllokimin e llogarive të këtyre subjekteve, si dhe janë konkluduar me referime në organet e zbatimit të ligjit. Aktivitete të subjekteve të tilla janë raportuar si raporte të aktivitetit të dyshimtë edhe nga bankat e nivelit të dytë, pas njoftimit që kanë marrë nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve të Shkodrës.
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, e cila krahas raporteve të aktivitetit të dyshimtë, raporton edhe deklaratimet e monedhës cash, në pikat e kalimit kufitar. Në vitin 2008 janë raportuar 6 RAD-e, nga të cilat dy janë arkivuar, dy janë referuar në organet e zbatimit të ligjit dhe dy janë në proces. Tipologjitë e këtyre raportimeve konsistojnë në importime në vlera të mëdha, deklarime të valutës në dalje në pikat e kalimit kufitar nga individë

After the initial financial analysis 29 cases have been referred to the law enforcement agencies. The rest of them, 60 SAR, are in the process of being analysed and additional data is being retrieved by GDPML.

Notaries, constitute the second most important category based on the volume of reports received as well as the quality of information. During 2008, 4 SAR have been filed by the notaries. The reason for suspicion is related to individual loans and sale of real estate and they are in the process of being analysed.

## Suspicious activity reports received by the partner institutions.

The following reports have been received by the partner institutions during 2008;

- Tax Authority, two suspicious transaction reports have been received and both have been referred to law enforcement agencies. It is worth mentioning that several reports have been received during this year, from the regional tax office in Shkodra related to 7 entities that act as petrol wholesalers and did not have physical presence in the listed addresses. GDPML has taken steps to freeze their accounts and they have also been referred to the law enforcement agencies. The commercial banks have also filed SAR regarding the above entities after they were noticed by the Shkodra tax office.
- Customs Authority, in addition to the suspicious activity reports is also charged with collecting cash declarations in the border crossings. In 2008 there have been altogether 6 SAR received from the customs authority, two cases have been referred to the law enforcement agencies, two cases are being further analyzed and two other cases have been archived
- The main typologies of these reports consist of high amounts of imports, declaration of currency in the border crossings from merchants that declare 'personal reasons' and 'medical

me aktivitet tregtar, të cilët deklarojnë si arsye: 'arsye personale' apo 'për kurim jashtë shtetit'. Ndërsa gjatë vitit të kaluar kishte 38 raportime të aktivitetit të dyshimtë pa elementë të mjaftueshëm dyshimi, RAD-et e ardhura në 2008-ën kanë ndryshuar në cilësi dhe kanë elementë dyshimi, fakt të cilin e tregon edhe referimi i tyre pas një analize të thellë financiare dhe investigative.

#### Deklarimet e valutës në pikat e kalimit kufitar

- Deklarimet e cash-it në pikat e kalimit kufitar, RTKK, kanë një rritje si në numër ashtu edhe në shumat e deklaruar. Në total, numri i personave që kanë deklaruar cash në dalje është 462, nga të cilët përkatësisht 455 nga Dogana e Rinasit, 3 nga Dogana e Vlorës dhe 4 nga Dogana e Qafë Thanës.
- Problematik mbetet deklarimi fiktiv i arsyes së mbartjes së valutës jashtë kufirit shqiptar, nga individë të cilët zhvillojnë aktivitet tregtar në Shqipëri dhe mbartin monedhë për qëllime biznesi, duke deklaruar se i mbartin për arsye personale (kurim, pushime, etj). Gjithsesi gjatë këtij viti është rritur numri i personave që deklarojnë në dalje, nga 336 në vitin 2007 në 462 në vitin 2008 (126 deklarime më shumë). Shumat e deklaruar janë: 5,817,100 Euro dhe 5,855,950 Dollarë. Deklarata e cash-it në kufi përmban informacion për deklarim si për shtetasit që hyjnë, ashtu edhe për shtetasit që dalin nga Republika e Shqipërisë. Deri më sot, deklarimet plotësohen vetëm nga shtetasit në dalje të territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, gjatë vitit 2008, ka raportuar 63 transaksione vlerash. Raportimi ka qenë i rregullt dhe nuk ka patur probleme në regjistrimin e tyre në programet e DPPPP- së. Raportimet e RTV- së, janë të pakta në numër krahasuar me informacionin nga noterët mbi kontratat e shitblerjes së pasurive të paluajtshme. Gjatë vitit 2008, janë bërë disa inspektime dhe janë dhënë masa administrative për shkeljet e konstatuara në disa nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, por që fatkeqësisht nuk kanë dhënë impakt në dedektimin e rasteve të dyshimta nga kjo zyrë.

treatment abroad'. The total number of SARs received in 2007 was 38 and contained few elements of suspicion. The quality of SARs filed in 2008 has changed and include sufficient elements of suspicion which indicates that their referral was carried out after a preliminary deep financial and investigative analysis.

#### Cross border cash declaration

- The currency declarations in the border crossings have also increased both in number and amounts declared. The total number of outgoing persons filling out a declaration was 462, out of which 455 in Rinas customs, 3 in Vlora customs and 4 in Qafe Thana customs.
- The fictitious declaration of the reason for the cash being transported outside the Albanian border from individuals who carry out trading activities in Albania. The reasons offered are (medical treatment, vacation, etc). The number of people declaring has reached 462 this year compared to 336 in 2007 (126 more). The total amount declared is : 5,817,100 Euro and 5,855,950 USD. The currency declaration form contains information for all people coming to or leaving Albania. Until now the declarations are filled only from citizens leaving the Republic of Albania.
- Central Office for the Registration of Real Estate , during 2008 a total of 63 value transactions have been reported. The reports filed have been most of the time accurate and there have been no problems in recording them in the GDPML database. The number of reports received has been low compared to the number of real estate contracts prepared by the notaries. During 2008 several onsite inspections have been carried out and administrative sanctions have been applied in some local offices. Unfortunately there has been no tangible impact in the detection of suspicious transactions from this agency.




## Raportimi i transaksioneve të vlerave nga bankat si subjekte kryesore raportuese

Përpara se të analizojmë RTV-të e ardhura nga subjektet raportuese, po japim një paraqitje grafike të raportimeve në vite që nga krijimi i Njif. Nga analizimi i grafikut vërejmë se ka dy hope të konsiderueshme:

1. Nga viti 2003, nga 880 raportime në 27709 në 2004 (pragu i raportimit ndryshon nga 70 milionë në 20 milionë lekë)
2. Nga viti 2007 me 61342 raportime në 231531 në 2008 (pragu i raportimit ndryshon nga 20 milionë në 6 milionë lekë).

Krahas ndryshimeve ligjore në vitin 2008, një indikator i rëndësishëm i rritjes së numrit të raportimeve ka qenë dhe rritja e numrit të inspektimeve dhe aplikimi i masave administrative. Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë kronologjike flukset e raportimeve që nga viti 2001.




Pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri numër 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” në datën 10 shtator 2008, raportimi i bankave u rrit në mënyrë të ndjeshme. Për periudhën shtator-dhjetor 2008, numri i transaksioneve (cash dhe jo cash) të raportuara zë 78% të numrit total të transaksioneve të raportuara gjatë vitit. Nga këto 60% rezultojnë si transaksione të kryera në monedhë cash (mbi 1.5 milionë).

## Reporting of value transactions from the entities

Before we start to analyze the VTR filed from the reporting entities, we are presenting a graphical overview of the reports over the years since the creation of the FIU. On first analysis two important surges can be noticed:


1. From 880 reports received in 2003 to 27709 reports in 2004 (threshold is reduced from 70 million Lek to 20 million lek)
2. From 61342 reports received in 2007 to 231531 reports in 2008 (threshold is reduced from 20 million Lek to 6 million lek)

Alongside the legislative changes in 2008 the higher number of onsite inspections and levying of administrative sanctions has contributed to the increase of the number of reports. The following chart presents the reporting flows chronologically since 2001.



After the Law No. 9917, of May 19, 2008 “On the prevention of money laundering and terrorism financing ” became effective in September 10, 2008, the number of reports received from the banks increased considerably. The number of transactions reported for the above mentioned period (cash and non cash) makes up 78% of the total number reported during the year. Out of those 60% were cash transactions (over 1.5 Million Lek).


Transaksione të raportuara nga bankat dhe krahasimi me një vit më parë / Reported bank transactions compared to the previous year



Vitin e kaluar, për periudhën shtator–dhjetor, raportimet e bankave si subjektet kryesore me fluksin më të madh të raportimeve, kishin shifrën e 21,766 RTV. Ndryshimet legjislative kanë shkaktuar një rritje mbi 8 herë të fluksit të raportimeve. Nëse do të përlogarisim edhe raportimet e noterëve, ky raport rritet më tej, duke nxjerrë si domosdoshmëri përsosjen dhe zhvillimin në teknologjinë e informacionit për përpunimin e informacionit, por edhe shtimin e stafit të DPPP-së.

Last year during the period September – December 2007, the reports from the banks account for most of the flow of reporting reaching a total of 21.766 VTR. The legislative changes have caused an eight fold increase of the flow of reports received and when the reports received from the notaries are included the number would be even higher. This increase highlights the need for the GDPML staff increase as well as perfection and development of information technology that would facilitate the processing of the information.

Paraqitja e raportimeve gjatë periudhës Shtator – Dhjetor 2008 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2007  
Reports received during the period September – December 2008 compared to the same period in 2007



Nga raportimet e bankave për transaksionet e kryera në cash në shuma të barabarta apo më të mëdha se 1,5 milionë lekë, shihet se numri i individëve që kryejnë transaksione cash është i lartë. Regjistrimi i gjithë

From the reporting of the cash transactions for the amounts equal or over 1.5 Million lek, it can be concluded that the number of cash transactions is high. The registration of all these transactions in

këtyre transaksioneve në bazën tonë të dhënave, bën të mundur rritjen e informacionit financiar në DPPP, duke evituar korrespondencën voluminoze me bankat për disa raste. Disa probleme janë vërejtur gjatë plotësimit të fushave të formularit nga bankat. Edhe pse iu është bërë herë pas here prezent një problem i tillë, masat e marra prej tyre nuk kanë qenë të mjaftueshme. Përveç kësaj, probleme janë hasur edhe me numrin e raportuar të këtyre transaksioneve në mënyrë elektronike me numrin e raportuar nga bankat në tabelat përmbledhëse në shkresat shoqëruese, problem që duhet zgjidhur nga punonjësit e TI- së dhe të raportuesve të bankave tregtare. Vërehet që në disa banka vazhdojnë të kryejnë transaksione të këmbimit valutor nga individë të palicensuar, transaksione biznesi nga llogaritë individuale të ortakëve apo administratorëve të bizneseve, transaksione të shumta të pajustificuara nga pikëpamja ekonomike, kryer nga individë që nuk kanë aktivitet tregtar ose nga shoqëri apo përfaqësues të tyre, transfertat këto të pashoqëruara me dokumentacionin përkatës, ose me përshkrimin “për shlyerje borxhi” në drejtim të kompanive/individëve përfitues jashtë shtetit, transaksione shit-blerje të pasurive të paluajtshme në shumta të konsiderueshme të padokumentuara, etj. Një tjetër fenomen i hasur është edhe ai i depozitimeve cash, ose transfertave në mbërritje me përshkrimin “të ardhura nga emigracioni”. Tetë raste me përshkrim “të ardhura nga emigracioni” janë finalizuar me referime pranë organeve të zbatimit të ligjit, pasi nuk është vërtetuar burimi i deklaruar i fondeve.

## Raportimi i transaksioneve të vlerave nga noterët dhe analizimi i tyre

Duke krahasuar me vitin e kaluar, numri i raportimeve është rritur ndjeshëm. Nga 89 RTV të raportuara nga noterët në vitin 2007, këtë vit kanë arritur në 6059 RTV. Faktorët që kanë ndikuar në shtimin e numrit të raporteve nga noterët janë:

- Inspektimet intensive të kryera në zyrat noteriale;
- Masat administrative të marra ndaj noterëve që nuk përmbushin detyrimet ligjore;
- Urdhëri i ministrit të Drejtësisë për zbatimin e kërkesave të ligjit mbi PP/FT, duke filluar nga momenti i hyrjes në fuqi për herë të parë të tij në vitin 2001;

our database ensures the increasing of financial information in the GDPML, avoiding thus the need for the huge exchange of information in several occasions.

Several problems have been encountered in the filling out of the reports and despite the notifications the measures taken have not been always sufficient. Difficulties encountered in the electronic reporting of transactions, their number listed in the accompanying summaries will have to be resolved by the IT specialists and compliance officers of the banks..

It is noted that several banks continue to conduct currency exchange transactions on behalf of unlicensed individuals, business transactions in the accounts of the shareholders and administrators, economically unjustified transactions executed by companies and their representatives without proper documentation, or transactions by individuals that do not have any commercial activity, transaction with individuals or companies abroad explained simply as “loan repayment”, large amounts of undocumented real estate transactions. Another phenomenon has been the cash deposits or incoming transfers with the description “immigration income”.

Eight cases related to the latter have been referred to the law enforcement agencies since no legitimacy of the source of funds could not be verified.

## Value transaction reporting from the notaries and their analysis

Compared to the previous year the number of reports has increased significantly. In 2007 there were 89 VTR reports filed by the notaries while the number of the VTR reports in 2008 were 6059. Some of the factors that have led to the significant increase are:

- Extensive inspections in notarie offices;
- Administrative sanctions applied for non compliant notaries;
- Order of Justice Minister for the implementation of AML/CFT law requirement since it entered into force in the year 2001;

- Bashkëpunimi me Dhomën Kombëtare të Noterëve në organizimin e trainimeve të përbashkëta për noterët për ndërgjegjësimin e tyre;
- Komunikimi i përditshëm me noterët, duke i sqaruar për plotësim të formularëve në mënyrë korrekte.
- Cooperation with the National Chamber of notaries in organizing joint awareness raising training sessions;
- Daily communications with the notaries, offering assistance on the accurate filling of the forms.


RTV të raportuara nga noterët sipas muajve / Monthly VTR reports by the notaries		
Viti / Year 2008	Të raportuara/reported	Të iniciuara/Initiated
Janar / January	0	0
Shkurt / February	53	0
Mars / March	90	0
Prill / April	1331	1
Maj / May	98	3
Qershor / June	60	2
Korrik / July	72	2
Gusht / August	572	1
Shtator / September	224	0
Tetor / October	434	2
Nëntor / November	622	0
Dhjetor / December	2503	8
<b>Totali / Total</b>	<b>6059</b>	<b>19</b>

Siç duket dhe nga tabela, fluksi i raportimeve ka qenë shumë i madh në muajt prill dhe gusht, si rrjedhojë e inspektimeve të kryera në vend dhe masave të marra kundrejt disa noterëve që nuk përmbushnin detyrimet ligjore. Pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri është vënë re një rritje graduale e numrit të raportimeve, duke arritur një fluks maksimal në muajin Dhjetor. Veç masave të mësipërme të ndërmarra, ky fluks raportimesh ka qenë rrjedhojë edhe e komunikimit të përditshëm me noterët, për të sqaruar informacionin e raportuar dhe për t'i udhëzuar në plotësimin e formularëve. Nga raportimet e noterëve, janë iniciuar 19 praktika, 8 prej të cilave vetëm në muajin dhjetor, kjo pasi informacioni i përmbajtur në këto raportime ka qenë mjaft i vlefshëm për qëllime të analizës. Vështirësi janë hasur në regjistrimin e informacionit të ardhur nga noterët pasi janë pjesërisht të plotësuar me shkrim të pakuptueshëm dore, kanë të dhëna të pamjaftueshme, shpesh nuk specifikohet

As we can see from the table, the number of reportings has been very high in the month of April and August, and this has come as a result of the on site inspections and the administrative sanctions imposed on noncompliant notaries. After the new law entered in force, a gradual increase in the number of reportings has been noticed and reaching a maximum in the month of December. Apart from the measures mentioned above, this number of reportings has also come as a result of the daily communication with the notaries, in order to clarify the reported information, and the instructions provided to them on how to fill the forms. The reports coming from the notary offices have led to 19 cases being initiated, 8 of which in the month of December and this due to the fact that the content of these reportings has been very valuable for the analysis purposes. There have been difficulties in registering the incoming information from the notary offices, due to the fact that the handwriting on them was illegible, the data was insufficient, in

burimi i të ardhurave dhe lloji i aktit noterial të nënshkruar, në rastet e kontratave të shit-blerjes së pasurive të paluajtshme nuk specifikohet objekti i kontratës, nuk specifikohen palët e përfshira në transaksion, etj. Të gjitha këto vështirësi do të përmirësohen me raportimin e të gjithë noterëve sipas formatit standart të raportimit dhe mundësimin të raportimit on-line. Aktualisht ka filluar raportimi on-line i disa noterëve si një plan pilot dhe po punohet për rritjen e elementëve të sigurisë në procesin e raportimit.


**Numri i noterëve që kanë raportuar sipas ndarjes gjeografike**



Numri i noterëve që kanë raportuar gjatë vitit 2008 ka arritur në 120 në krahasim me 18 të vitit të kaluar. Fluksin kryesor të raportimeve e zë qyteti i Tiranës, por risi tjetër e raportimeve të noterëve është shpërndarja gjeografike e tyre. Raportimet vijnë nga qytetet: Durrës, Elbasan, Fier, Kavajë, Korçë, Lushnje, Lezhë, Shkodër, Vlorë, Sarandë, duke mbuluar të gjithë Ultësirën Perëndimore, që është edhe pjesa me zhvillim ekonomik dhe transaksione të ndjeshme krahasuar me territorin tjetër të Shqipërisë. Ky është një tregues tjetër i sensibilizimit të të gjithë noterëve për rëndësinë e zbatimit të detyrimeve ligjore të përcaktuara në Ligjin nr.9917, datë 19.05.2008, si dhe i kryerjes të inspektimeve mbi bazën e rrezikut.

many cases the source of the incomes was not specified along with the type of the notarial document, in the case of real estates dealings the object of the contract is not specified, the parties involved in the transaction are not specified, etc. All these difficulties will be overcome with the reporting of all notary offices in conformity with the standards of the reporting and the on-line reporting option being enabled. At present, an online reporting by several notary offices is taking place, part of a pilot project, and efforts are being made on increasing the security elements in the reporting process.

**Notary Reports filed by geographic location**



The number of notary offices which have reported during 2008 has reached 120 compared to 18 last year. The majority number of reports comes from Tirana, but what should be highlighted is the wide geographic spreading of the number of reportings throughout the country. The reportings come from the following cities: Durrës, Elbasan, Fier, Kavajë, Korçë, Lushnje, Lezhë, Shkodër, Vlorë, Sarandë, covering the Western Lowlands, which is where most of the the economic development takes place, and a significant number of transactions compared to the rest of Albania. This is another indicator of the awareness of all notary offices on the importance of meeting legal obligations determined in the Law No.9917, of May 19, 2008, and the inspections conducted based on a risk evaluation.

## Raportimi i transaksioneve të vlerave nga subjektet e tjera të ligjit

Gjatë vitit 2008 ka pasur raportime edhe nga subjekte të tjera të ligjit si:

- Shoqëritë e Tregtimit të Mjeteve Motorike kanë raportuar 140 transaksione vlerash. Raportimi i këtyre subjekteve në përgjithësi ka qenë në format të kuptueshëm, gjë që ka mundësuar regjistrimin e tyre në bazën tonë të të dhënave. Kjo është arritur falë komunikimit me personat e kontaktit dhe nga inspektimet e kryera në vend. Gjithsesi, jo të gjitha këto subjekte përbushin kërkesat përsa i përket formateve të raportimit. Me këto subjekte problemi i konstatuar ka qenë raportimi në vlera agregate duke mos dhënë emrat e klientëve. Pas insistimit dhe komunikimeve të vazhdueshme kemi siguruar raportime të detajuara, ku përfshihen edhe emrat e klientëve. Raportimi i këtyre subjekteve për herë të parë gjatë këtij viti përbën risi.
- Zyrat e Këmbimit Valutor kanë raportuar 179 transaksione vlerash. Shumica e raportimeve nuk ka qenë në formatin e kërkuar për të mundësuar regjistrimin e informacionit në bazën tonë të të dhënave. Raportimet bëhen në shumë agregate ditore ose javore, pa dhënë informacionin e duhur mbi numrin dhe llojin e transaksioneve të kryera apo klientët që i kanë kryer ato. Për këtë problem janë vënë në dijeni strukturat në ndjekje të tij. Gjatë vitit të kaluar ishin vetëm 75 raportime të transaksioneve të vlerave.
- Institucionet Financiare jo-Banka kanë raportuar 213 transaksione gjatë vitit 2008 kundrejt 79 raportimeve të vitit të kaluar. Vetëm një nga këto subjekte raporton në format elektronik. Edhe ato që kanë raportuar në format të tillë kanë pasur probleme në regjistrimin e të dhënave, probleme që do të zgjidhen edhe këto me standartizimin dhe raportimin on line.
- Kazino/Lojra Fati kanë raportuar 38 transaksione vlerash. Formatin e raportimit është i rregullt dhe të dhënat janë regjistruar në bazën tonë të të dhënave. Niveli i raportimit është më i ulët krahasuar me vitin e kaluar.


## Reporting of value transactions from other legal entities

During 2008 there have been reports from other legal entities such as:

- Car dealers have reported 140 VTR. The reporting made by these entities in general has been in an understandable format, which has enabled their registration in our database. This has been achieved thanks to the communication with the contact individuals and thanks to the inspections carried out on site. Nonetheless, not all of these entities meet the requests as far as the format of reporting is concerned. With these entities, the problem which has been identified relates to the reporting with aggregate values by not providing the names of the customers. After insisting and continuously communicating, we have received detailed reports where the customer names are included. The reportings made by these entities for the first time this year is a new thing.
- Exchange bureaux have reported 179 value transactions. The majority of the reportings has not been in conformity with the required format, in order to enable the registration of the information in our database. The reporting is made in a daily or weekly aggregate values, without providing the necessary information on the number or the type of transactions carried out, or the customers who have carried them out. This problem is being tackled by the respective structures. The number of reported value transactions last year was only 75.
- Non bank institutions, have reported 213 transactions during 2008, as opposed to 79 reportings being made last year. Only one of these entities reports in an electronic format. The other ones who have reported in such way have led to problems in the registration of the data, problems which will be resolved with the standardization of the on line reporting.
- Casinos/Games of chance have reported 38 value transactions. The reporting format is correct and the information has been registered in our database. The number of reports is lower than last year.

- Fondacion/Kompani kanë raportuar edhe ato për herë të parë në vitin 2008. Numri total i raportimeve ka qenë 7, transaksione këto të raportuara nga 2 kompani ndërtimi. Raportimi ka qenë në format të kuptueshëm dhe ka bërë të mundur regjistrimin e tyre.
- Foundation/Companies have reported for the first time in 2008. The total number of reports has been 7, which have been made by two Construction Companies. The reporting has been in an accurate format and their registration has been possible.

Në mënyrë të përmbledhur grafiku paraqet raportet e ardhur nga subjektet, të krahasuar me vitin 2007 /  
The graphic below shows the reports which have been sent by entities, in comparison to 2007



## Analizimi financiar dhe teknologjia e informacionit

Rëndësi e veçantë i është kushtuar analizës financiare të raporteve të mbërritura në DPPPP. Për këtë qëllim, në ndryshimet strukturore të propozuara është rritur numri i specialistëve në Sektorin e Analizës nga tre në pesë analistë. Krahas faktorit njerëzor, theksi i është vënë teknologjisë së informacionit, bazuar në faktin që si NjIF administrativ, disponojmë informacione e raporte të shumta në numër.

Duke qenë se nuk ka pasur fare programe për menaxhimin e rasteve, Sektori i Teknologjisë së Informacionit punoi intensivisht që me krijimin e tij dhe në korrik 2008, u konkludua ndërtimi dhe vënia në përdorim e programit të administrimit të praktikave (dosjeve investigative). Ky program informatizon dhe centralizon të gjithë informacionin që aktualisht ka në dispozicion DPPPP-ja dhe ndihmon analistët në konsultimin e shpejtë dhe nxjerrjen e konkluzioneve të sakta për rastet.

## Financial Analysis and Information technology

Special attention has been paid to the financial analysis of the reports received by FIU. It's for this reason that the structural changes which have been proposed have consisted on the increase of the number of specialists in the Analysis Sector, and the number will be increased from three to five analysts. Apart from the human factor, the information technology has been prioritised, based on the fact that being an administrative FIU, we possess a lot of information. Given that there have been no case management programs, the Information Technology Sector worked vigorously and succeeded in establishing it in July 2008. The construction and the functioning of the case management program (investigative files) was accomplished. This program digitalizes and centralizes all of the information that FIU currently possesses and assists the analysts to have a quick consultation and to draw accurate conclusions on the cases.

Disa prej zhvillimeve më të rëndësishme në fushë e TI-së, që synojnë ta rendisin Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) në radhë me homologët e saj, kanë qenë:

- Instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve hardware në kuadrin e Programit CARDS 2004, me fondet e Delegacionit të BE-së që është përfunduar me sukses. Ai përfshin ristrukturimin e rrjetit kompjuterik, vendosjen e centralit telefonik, si dhe vendosjen e sistemit të sigurisë. Ky sistem teknologjik bashkëkohor i mundëson DPPPP-së marrjen dhe analizimin e informacionit online të raportimeve nga bankat e nivelit të dytë apo subjekte të tjera raportuese të ligjit, duke përdorur kanale të sigurta informacioni. Lejon mundësinë e ruajtjes së këtij volumi raportimesh, analizimi dhe sjell fleksibilitet në përdorimin e programeve analitike në këtë mënyrë, rritjen e cilësisë dhe shpejtësisë së punës së DPPPP-së.
- Fillimi i raportimeve online. Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit", DPPPP-ja është ndeshur me fenomenin e rritjes së numrit të raportimeve nga bankat e nivelit të dytë. Ky fenomen ka sjellë problemet e para me programin kompjuterik ekzistues dhe lindjen e nevojës urgjente për ndërtimin e modulit të raportimit online të informacionit. Si fazë pilot, ky modul është vendosur në dy banka dhe rezultati i deritanishëm ka qenë i suksesshëm, duke sjellë fleksibilitet dhe shpejtësi raportimi. Moduli i zhvilluar është konform Ligjit nr. 9917 dhe gjithashtu bazuar mbi sugjerimet e bankave të nivelit të dytë. Me vendosjen e këtij moduli besojmë se do të kryhet në një afat të shkurtër raportimi duke sjellë shpejtësi dhe fleksibilitet. Moduli i raportimit të informacionit për vitin 2008 është konkluduar me vendosjen e Bankës Ndërkombëtare Tregtare online.
- Ndërtimi i një programi të plotë analitik. Në kuadrin e Programit CARDS 2005, me fondet e Delegacionit të BE-së, është realizuar prokurimi i një programi analitik. Më 19 nëntor 2008 është bërë dhe hapja zyrtare e fillimit të punës për këtë program, i cili mendohet të zgjasë gjashtë muaj. Deri tani janë bërë testimet e para, ndërsa instalimi i versionit të parë të këtij programi do të jetë javët e para të janarit 2009. Programi bazohet në katër pika kryesore:
  - Sigurinë e informacionit, për të arritur parametret e përcaktuar nga DSİK;

Some of the most important developments in IT, which aim at putting the Financial Intelligence Unit alongside its homologues, are:

- The installation and configuration of hardware equipment in the framework of CARDS Program 2004 with the funds of the EU Delegation, which has successfully been achieved. It includes the reconstruction of the computer network, the installation of the centrally operated phone system and the establishment of the security system. This contemporary technological system, allows FIU to receive and analyze the reports coming from commercial banks or other entities which have a reporting obligation, online, by using secure channels of information. This offers the opportunity to store the reports, to enhance the flexibility in the utilisation of analytical software in order to increase the quality and the speed of FIU's work.
- The start of online reportings. With the entry in force of Law No. 9917, of May 19, 2008 "On the prevention of money laundering and terrorism financing", GDPML has been confronted with an increase in the number of reportings from second level banks. This phenomenon has brought the initial problems with the current computer programs and the urgent need of building the module of the online information reporting. This module which is still in the testing stage, has been installed in two banks and the result so far has been successful in bringing flexibility and speed reporting. The developed module is in conformity with law 9917 and is also based on the suggestions of second level banks. With the installation of this module, we believe that the reporting will be expedited allowing thus for speed and flexibility. The module of the reporting of information for 2009 has been concluded with the establishment of the online service from the Commercial International Bank.
- The building of an analytical program. In the framework of 2005 CARDS Program, with the funds of the EU Delegation, the procurement of an analytical program has been enabled. The project commenced on November 19, 2008 and is scheduled to last six months. Preliminary tests have been carried out already, whereas the installation of the first version of this program will be made in the early weeks of January 2009. The program is built around four main pillars:
  - Security of information, in order to achieve the parameters



- Administrimin e çështjeve, në një nivel më të lartë se aktual
- Module vizive të Analizës së Informacionit, për të ndihmuar analistët;
- Mbledhja e informacionit (online nëpërmjet ndërfaqeve të sigurta me minimum 128 bit kodim, gjithashtu dhe offline). Kjo do të ulë kostot për subjektet raportuese dhe do mundësojë marrjen në kohë reale të raporteve për tu analizuar nga DPPP- ja.
- Bashkëpunimi shumë i mirë me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), ka sjellë përfitime për stafin e teknologjisë së informacionit në fushën e trajnimeve, duke rritur nivelin e profesionalizmit. AKSHI, gjithashtu, ka inkluduar Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave në rrjetin GOV. NET, duke planifikuar që në vitin 2009 institucioni të jetë pjesë e këtij rrjeti kombëtar nëpërmjet fibrës optike.
- Ndryshime në rikonceptimin e faqes zyrtare të internetit, e cila mundëson rritjen e shkallës së informimit për subjektet e ligjit dhe për publikun në tërësi.

- determined by NIA;
- Further upgrade of case administration;
- Visual modules of the Analysis of Information, to assist analysts
- The collection of information (online through secure interfaces with a minimum of 128 bit coding as well as offline). This will reduce the costs of the reporting entities and will enable the reports to be received in real time in order to be analysed by FIU.
- The excellent cooperation with the National Agency of the Information Society (NAIS) has yielded benefits for the staff of the technology of information in the training domain, thus increasing the level of professionalism. NAIS has also included the Financial Intelligence Unit in the GOV.NET network, planning to make this institution in 2009 part of this national network through the fibre optic connection.
- Reconfiguration of the official GDPML website which enables the increase of the level of information for legal entities and public in general.

Faqja zyrtare e vjetër / Old official website



Faqja zyrtare e re / New official website

## Referimi i rasteve të dyshimta në prokurori

Gjatë vitit 2008 është vërejtur një rritje e konsiderueshme e referimeve në Prokurori dhe e kallëzimeve në Polici. Krahasuar me vitin 2007, ku kemi pasur vetëm 7 referime në organet ligjzbatuese, tregon për një rritje mbi 10 herë të këtyre rasteve nga DPPP-ja. Kjo ka ardhur si rezultat e rritjes së kërkesës së llogarisë ndaj stafit të analistëve, rritjes së numrit të analistëve, futjes së teknologjive të informacionit në përdorim, rritjes së nivelit të menaxhimit, si dhe përmirësimit të bashkëpunimit e shkëmbimit të informacionit me institucione partnere dhe organet e zbatimit të ligjit. Në formë tabelare paraqitet rezultati final i punës së DPPP-së: Dërgimi i rasteve për investigime të mëtejshme pranë Prokurorisë janë 21 për pastrim parash dhe 5 për këmbime valutore të palicencuara. Në

## The referral of suspicious cases to the prosecutor's Office

During 2008, a significant increase has been observed in the number of referrals to the Prosecution and the reports sent to the police. Compared to 2007, where we have only had 7 referrals to the law enforcement institutions, indicates an increase by ten times of these cases by FIU. This has come as a result of the increase in demands for higher accountability from the staff of analysts, the introduction of the use of information of technology, the increase of the level of management and the improvement of cooperation in the exchange of information with partner institutions and law enforcement institutions. The result of the work of FIU is shown in the table below.

	Dërguar në Polici për investigim/ Forwarded to the Police for further investigation	Referuar në Prokurori/ Referred to the Prosecutor's Office	Totali/ Total
Për pastrim parash/ML	37	21	58
Për financim terrorizmi/FT	1	0	1
Kambizëm valutor i palicensuar/Unlicensed Currency Exchange Operations	6	5	11
Mosdeklarim i vakutës në kufi/ Cross border non Currency Declaration	2	0	2
<b>TOTALI / TOTAL</b>	<b>46</b>	<b>26</b>	<b>72</b>

këto raste përfshihen edhe persona të ekspozuar politikisht, kjo dhe në përputhje me vigjilencën e zgjeruar të parashikuar nga Ligji nr. 9917, datë 19.05.2008.


Analiza financiare është një metodë indirekte tepër efektive e mbledhjes, organizimit dhe paraqitjes së evidencës në lidhje me gjendjen financiare të individit apo shoqërisë. Rastet e referuara konsistojnë në faktin që të mund të tregohet se "target-i", nuk mund të demonstrojë një burim të ligjshëm për të justifikuar pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme që zotëron. Gjurmimi i këtyre veprimeve mund të çojë gjithashtu drejt zbulimit të veprave paraprake kriminale, nga ku rrjedhin burimet e të ardhurave. Në rastet e referuara pranë Njesisë së Përbashkët Hetimore të Prokurorisë Tiranë, vepra penale e origjinës ka qenë trafiku i drogës, trafiku i qenieve njerëzore, trafiku i organeve, korrupsioni etj. Po kështu

